

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **SPITALI FERIZAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **220/70060-26-4794-2-2-1**

Sa i përket tenderit për: „**Servisimi dhe mirëmbajtja e Aparaturave mjekësore në këto Raparte Interno, Kirurgji, Emergjence, Blloku Operativ, Hemodialize dhe Gjinekologji**”
me numer te prokurimit-018-2026

1. Identifikimi OPERATORITEKONOMIK

LEOMED SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Ilmi Rakovica Kati I 2 Nr 9

(Adresa)

PRISHTINË

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

049/725-777

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Xhemë Asllani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Xheme.asllani@leomed.org

(Adresa elektronike)

07.07.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

LEOMED
MEDICAL EQUIPMENT
Nr. fiskal 601675955

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti kontraktues – **SPITALI FERIZAJ** me datë **17.06.2026** ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: „ **Servisimi dhe mirëmbajtja e Aparaturave mjekësore në këto Raparte Interno, Kirurgji, Emergjence, Bloku Operativ, Hemodialize dhe Gjinekologji**” me numer të prokurimit-018-2026

- Procedurë e hapur,
- Kontrate publike - Kornizë
- Shërbim, Vlerë e mesme
- Vlera e parashikuar e kontratës 99,000.00 euro
- Kriteri për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët

- Afati i fundit për dorëzim të tenderëve i shkurtuar, data e dorëzimit 30.06.2026 ora:12:00, Vendi: Përmes Platformes E-Prokurim, Takimi për hapjen e tenderëve Spitali Ferizaj.

MIRËPO,

- **Me datë: 25.06.2026 – AK Spitali Ferizaj publikon NJOFTIMI MBI VENDIMIN PËR ANULIMIN E AKTIVITETIT TË PROKURIMIT**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

x

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

1. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pa kënaqur me Vendimin për Anulimin e **NJOFTIMIT PËR KONTRAT** të AK- Autoriteti kontraktues – **SPITALI FERIZAJ** dhe në pajtim me nenin 108/A të LPP-së parashtrajmë Kërkesë për Rishqyrtim kundër;

- **NJOFTIMIT MBI VENDIMIN - PËR ANULIMIN E AKTIVITETIT TË PROKURIMIT të datës: 25.06.2026**

Pretendojmë se **SPITALI I FERIZAJT**, përmes Zyrës së Prokurimit ka bërë shkelje të dispozitave ligjore si në vijim;

❖ Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejme do të i referohemi LPP-së) dhe atë;

- Neni 1, Qëllimi, par 2 dhe 3.
- Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 6;
- Neni 9, Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur, par 1,2 dhe 3
- Neni 17, Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime
- Neni 62, Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, par 1, 1.1, 2, 2.1,2.2

❖ Dispozitat e Rregullores nr. 02/2024 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejme do të i referohemi RRPP) dhe atë:

- Neni 8 Përcaktimi i nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve
- Neni 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit, par, 43.8
- Neni 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen par (d), (k) dhe (o).

2. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

- **Të pa kënaqur me Vendimin për Anulim** parashtrijmë Ankesën dhe pretendimet tona ankimore kanë të bëjnë me anulimin e aktivitetit të prokurimit në mënyrë arbitrare me arsyetim të rremë, i paargumentuar dhe në shkelje drastike të **Nenit 62** të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (LPP), përmes Vendimit të AK-së të datës 25.06.2026

Provë 1. Vendimi i AK i datës: 25.06.2026



B58- NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:

Lënda: **Servisimi dhe mirëmbajtja e Aparaturave mjekësore në këto Raparte: Interno, Kirurgji, Emergjence, Blloku Operativ, Hemodialize dhe Gjinekologji** me numer të prokurimit-018-2026

Prokurimit: 220-24-4415-2-2-1 dhe i brendshëm- **018-2026**

Spitali Pergjitheshem Ferizaj

E Anulon Aktivitetin e perokurimit per keto Arsije:

Anulohet aktiviteti i prokurimit për Lënden : **Servisimi dhe mirëmbajtja e Aparaturave mjekësore në këto Raparte Interno, Kirurgji, Emergjence, Blloku Operativ, Hemodialize dhe Gjinekologji** me numer të prokurimit-018-2026

Pasi që në specifikimin teknik të Çmimit janë gjetur disa gabime nga njësia kërkuese psh të Aparaturat mjekësore ju mungojn Kodet dhe sasia si dhe të numri rendor 63 është bërë një gabim teknik , Kështu që me një rekomandim nga Bio inxhinjeri I SHSKUK së për Paisje Mjekësore rekomandon që ky Aktivitet i prokurimit të Anulohet dhe të korigjohen gabimet e gjetura në Specifikim teknik.

Sami Malsiu Ud. Shef I prokurimit  me date 25.06.2026

Autoriteti Kontraktues – Spitali Ferizaj ka nxjerrë një vendim skandaloz me arsyetimin duke u thirrur në:

1. Gabime të gjetura nga njësia kërkuese ;
 2. Mungese të sasive të aparaturave mjekësore; dhe
 3. Një rekomandim të një Bio-inxhinjeri të SHSKUK – por të cilin nuk e ka publikuar.
- Atyku pretendohet se "*aparaturave mjekësore ju mungon sasia*" Ky pretendim i AK-së është një **e pavërtetë absolute**. Në paramasën/specifikimin teknik të hartuar dhe publikuar nga vetë AK-ja, **sasia është e përcaktuar saktësisht për secilin pozicion** nga 1 deri në poz. e fundit 123. **ANDAJ, lirisht mund të themi se pretendimi se mungon sasia përbën falsifikim të gjendjes faktike të dokumentacionit zyrtar të publikuar në platformën elektrike E-prokurimi.**

- Te poz. 63, AK-ja ka shkruar "*SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E RREGULLT E PAISJEVE*" me sasi 12 shërbime. Pretendimi i Autoritetit Kontraktues se Pozicioni 63 përmban "gabime" është një shpifje administrative dhe manipulim i pastër faktik. Ky pozicion është plotësisht i definuar: kërkohet "*Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt*" dhe është përcaktuar sasia e saktë prej "12" shërbimeve.
- Dhe pika si më skandaloze është se AK- Spitali Ferizaj ka marrë një vendim duke u bazuar në një "Rekomandim të një Bio-inxhinjeri të SHSKUK-së", dokument ky i cili **nuk është publikuar askund** në platformën e-Prokurimi dhe nuk u është ofruar OE-ve. Vendimet e tilla nuk mund të bazohen në "shkresa sekrete" apo dokumente inekzistente. Për sa kohë që ky rekomandim mbahet i fshehur, ne si Operator Ekonomik ngrisim dyshime të bazuara se ky dokument **nuk ekziston fare**, ose përmbajtja e tij është manipuluar për të krijuar një kauzë artificiale për anulim. Ky manipulim administrativ ka për qëllim të vetëm eliminimin e konkurrencës dhe favorizimin në të ardhmen e operatorëve ekonomik të caktuar.

MADJE,

Ne si Operator Ekonomik kemi ushtruar zyrtarisht të drejtën tonë duke kërkuar qasje në dokumente në këtë 'Rekomandim' të pretenduar të Bio-inxhinierit.

Provë 2. Kërkesa për qasje në dokumente

Të nderuar,


Pas Njoftimit për Anulim të datës 25.06.2026 për aktivitetin e prokurimit "*Servisimi dhe mirëmbajtja e Aparaturave mjekësore...*" (Nr. i Prokurimit: 018-2026), dhe duke u thirrur në **Nenin 10, paragrafi 3 (pika III) dhe paragrafi 4 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP)**, kërkojmë zyrtarisht qasje të menjëhershme dhe kopje të:

1. **Raportit / Rekomandimit të shkruar të Bioinxhinierit të SHSKUK-së**, i cili ka shërbyer si bazë për marrjen e këtij vendimi për anulim.

DHE,

Pas kërkesës për qasje në dokumente, Autoriteti Kontraktues – Spitali Ferizaj, ka kthyer përgjigje zyrtare me email (e cila i bashkëngjitet kësaj shkrese si Provë 3).

Provë 3.



Edhe pse pranuar zotimin zyrtar nga Autoriteti Kontraktues përmes këtij e-maili, ku deklarohej se do të na kthehej përgjigje e plotë me datë 29.06.2026, **ne nuk kemi pranuar asnjë përgjigje apo dokument nga ana e tyre**. Andaj, dyshojmë se bioinxhinieri në fjalë, *për të cilin nuk ekziston asnjë vendim zyrtar emërimi, nuk ka qenë i autorizuar nga SHSKUK-ja për të ndërmarrë këto veprime. Ekziston dyshimi i bazuar se këto ndërhyrje janë bërë me qëllim kurdisjen e tenderit në të ardhmen për të siguruar përfitime të paligjshme*. Për këtë arsye, bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, kërkojmë nga SHSKUK-ja të na ofrojë qasje në dokumentacionin përkatës për të verifikuar nëse ky person ka pasur ndonjë autorizim zyrtar për këtë veprim.

Tutje,

Pas një analize kronologjike të aktiviteteve të prokurimit të këtij Autoriteti Kontraktues, rezulton se Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj **ka tenderuar dhe ka lidhur kontrata në vitet e kaluara me të njëjtën paramasë dhe të njëjtat specifikime teknike**. Ky fakt vërtetohet qartësisht nga aktivitetet e mëparshme të suksesshme të prokurimit të shpallura nga vetë AK-ja, konkretisht nën numrat e prokurimit:

- **Nr. i Prokurimit: 220-20-971-2-2-1 (Viti 2020)**
- **Nr. i Prokurimit: 220-22-3022-2-2-1 (Viti 2022)**
- **Nr. i Prokurimit: 220-24-4415-2-2-1 (Viti 2024)**

Në ato procese, as "njësia kërkuese" dhe as ndonjë "Bio-inxhinier" nuk kanë gjetur asnjë gabim sa i përket sasisë apo kodeve.

Pyetja legjitime që shtrohet në këtë rast është: **Si bëhet që një paramasë që ka qenë e ligjshme dhe e saktë për vite me radhë, papritmas po tentohet të quhet "me gabime" në vitin 2026?**

Andaj, kjo e vërteton plotësisht se anulimi nuk është bërë për shkaqe teknike, por është një **tentativë e hapur për kurdisje të procesit në të ardhmen**. AK-ja po tenton të eliminojë konkurrencën e rregullt aktuale për të përgatitur terrenin për një proces të montuar dhe të përshtatur për interesa të caktuara klienteliste.

Ky veprim përbën devijim të rëndë të qëllimit të LPP-së dhe keqpërdorim të fondeve publike.

POASHTU,

Vlen të theksohet se në këtë Aktivitet Prokurimi (AP), nga ana e Operatorëve Ekonomikë (OE) **nuk ka pasur asnjë kërkesë për sqarim apo paqartësi** lidhur me dokumentacionin e tenderit. Ky element përbën një tregues të rëndësishëm objektiv se Dosja e Tenderit (DT), paramasa dhe specifikimet teknike kanë qenë të qarta, të sakta dhe të kuptueshme.

Në pajtim me **Nenin 24** të RRPP-së Nr. 02/2024 (paragrafët **24.1 dhe 24.2**), çdo OE ka pasur të drejtën ligjore që, përmes funksionit të dedikuar "sqarimet e DT" në platformën elektronike, të kërkonte informata shtesë brenda afateve kohore nëse do të haste në paqartësi. *Fakti që asnjë konkurrent nuk ka shprehur asnjë kërkesë për sqarime përmes këtij mekanizmi zyrtar dëshmon se paramasa ishte e saktë dhe se anulimi i këtij aktiviteti nuk bazohet në asnjë shkak objektiv, por është një vendim i njëanshëm që bie ndesh me parimet e prokurimit publik.*

Për më tepër,

Autoriteti Kontraktues ka shpallur paralelisht edhe dy aktivitete të tjera të prokurimit në të njëjtën fushëveprimtari:

- **Aktiviteti i Prokurimit Nr. 014-2026**
- **Aktiviteti i Prokurimit Nr. 015-2026**

Këto dy aktivitete kanë strukturë të njëjtë të paramasës dhe të specifikimeve teknike si aktiviteti ynë i anuluar. Megjithatë, në ato dy procese, as "njësia kërkuese" dhe as "Bio-inxhinieri" i pretenduar nuk kanë gjetur asnjë gabim sa i përket sasisë, përshkrimit apo kodeve, dhe të njëjtat po vazhdojnë rregullisht pa u anuluar.

Ky veprim përbën shkelje drastike të **Nenit 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim / Jodiskriminimi)**. AK-ja nuk mund të aplikojë standarde të dyfishta: të konsiderojë një model paramase si të ligjshëm për dy tenderë (014-2026 dhe 015-2026), dhe të njëjtin model ta shpallë "me gabime" dhe ta anulojë vetëm për tenderin tonë (Nr. 220/70060-26-4794-2-2-1). Ky selektim dëshmon se anulimi nuk është bërë për shkaqe ligjore apo teknike, por me qëllim të vetëm për të eliminuar konkurrencën e rregullt. Përkundër fakteve dhe argumenteve:

Përkundër fakteve dhe argumenteve të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim:

Përkundër argumenteve dhe provave të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim të datës: 30.06.2026 Autoriteti Kontraktues –SPITALI FERIZAJ merr vendim për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim duke dhënë vetëm arsye të pa argumentuar, joligjore dhe që bie ndesh me nenin **108/A, paragrafi 12**, i cili citon ‘ ‘ *Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë*’ ’.

Provë 3. Përgjigjeja ndaj Kërkesës për Rishqyrtim



Të nderuar: „LEOMED“ SH.P.K., Rr.Hilmi Rakovica Kati I 2 Nr.9, 10000, PRISHTINË, Kosovë,

Titulli: Servisimi dhe mirëmbajtja e Aparaturave mjekësore në këto Raparte Interno,Kirurgji,Emergjence, Blloku Operativ,Hemodialize dhe Gjinekologji” me numer te prokurimit-018-2026

ZYRA E PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit – AK-së, në bazë të Nenit 108/A të Ligjit nr 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr 04/L-237, Ligji nr 05/L-068 dhe Ligji me nr 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës së Parashtruar për **Rishqyrtim** të datës: 25.06.2026 në Platformën e E-Prokurim nga Operatori Ekonomik Lidhur me Aktivitet e Prokurimit menumer të prokurimit”

Numër të Prokurimit: **220/70060-26-4794-2-2-1**dhe i mbendeshem-018-2026

Vendosë këtë Vendim

VENDIM

REFUZOHET si e pa bazuar – Kërkesa për Rishqyrtim në Platformën E prokurim të datës **25.06.2026**, parashtruar nga Operatori Ekonomik „LEOMED“ SH.P.K

ARSYETIM

AK e ka shqyrtuar me kujdes kërkesën tuaj për **RISHQYRTIM** dhe **REFUZOHET** si e pa bazuar.

Ju njoftoj se Anulimi i Aktivitetit të prokurimit është bërë Para Hapjese së Tenderit me datë 25.06.2026 për këto Arsye:

Pasi që në specifikimin teknik të Çmimit janë gjetur disa gabime nga njësia kërkuese p.sh. te Aparaturat mjekësore ju mungojn **Kodet me numra serik** , **sasia**(nga sa Copë) **Autorizimet** nga prodhuesi për secilen paisje si dhe te **numri rendor** me **Nr. 63** është bërë një gabim teknik , pasi aty te numri rendor nuk mundet te vendoset asnje qmim pasi është shku në shumës për paisje mjekësore, kështu që me një rekomandim nga Bio ingjinjeri i SHSKUK së për Paisje Mjekësore rekomandon që ky Aktivitet i prokurimit të Anulohet dhe të korrigjohen gabimet e gjetura në Specifikim Teknik dhe kjo procedure te Anulohet dhe të Ritenderohet. Është e vertetë që informacionet shtesë kane qënë deri me datë 25.06.2026 dhe nuk kena pranuar asnje Kërkesë për sqarin në dosje të tenderit, po në këtë rastë AK zyra e prokurimit e sheh të arsyshme që te Anulohet kjo procedure pasi ka shumë gabime në Specifikim Teknik dhe kjo procedure pregaditet për Ritenderim.

Kërkesa për **Rishqyrtim bazuar** ne nenin 108/A të ligjit me nr.04/L-042 Për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe i plotsuar me ligjin nr.04/L-237,Ligjit 05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092.

Pranadaj Kërkesa Për Rishqyrtim Refuzohet konform LPP-se.

Autoriteti Kontraktues – Spitali Ferizaj ka respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Nr. 04/L-042

Me date: 02.07.2026

Ud. Shef i Prokurimit

Samir Malsiu

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga Autoritetit Kontraktues ka nxjerrë në pah një **manipulim të pastër administrativ** dhe **shkelje drastike të parimit të transparencës**. Edhe pse AK – Spitali i Ferizajt u zotua zyrtarisht përmes e-mailit se me datë 29.06.2026 do të ofronte përgjigje të plotë dhe do të vendoste në dispozicion dokumentacionin, ky **zotim zyrtar u shkel plotësisht**, duke mos dërguar asnjë shkresë.

Ky dështim vërteton përfundimisht se i ashtuquajtimi "**Rekomandim i Bio-inxhinierit të SHSKUK-së**" është **plotësisht inekzistent** dhe është përdorur vetëm si një **pretekst fiktiv për të ndërtuar një kauzë artificiale për anulimin** e të gjithë Aktivitetit të Prokurimit.

Për më tepër, pretendimet e AK-së për "gabime teknike, mungesë të sasive dhe kodeve" hidhen poshtë plotësisht, pasi paramasa e publikuar në platformën E-Prokurimi ka qenë e saktë dhe e detajuar nga pozicioni 1 deri në 123. **Mungesa e një vendimi zyrtar emërimi apo autorizimi** nga SHSKUK-ja për bio-inxhinierin në fjalë ngre dyshime të bazuara se kemi të bëjmë me një **ndërhyrje të paautorizuar administrative me qëllim të vetëm kurdisjen e tenderit në ritenderim**.

Ky veprim përbën **shkelje të Nenit 62 të LPP-së** dhe ka pasur synim **eliminimin e konkurrencës së ligjshme** për të favorizuar operatorë të caktuar ekonomikë në të ardhmen.

Andaj, ky veprim i AK- Spitali Ferizaj, nuk ka të bëjë fare me anulimin e aktivitetit të prokurimit siq parashohin dispozitat ligjore para hapjes së ofertave.

SEPSE;

Dihet mirë se kur mund të anulohet aktiviteti i prokurimit pas hapjes së ofertave:

Pra, Autoriteti Kontraktues, në kundërshtim me dispozitat e LPP-së: Neni 62, Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, par 1, 1.1, 2, 2.1, 2.2 si dhe nenit 43 të RRPP-s, par, 43.8, nxjer Njoftim mbi Anulimin e aktivitetit të prokurimit, **i kujtojmë AK se çdo veprim jashtë këtyre neneve është në kundërshtim me legjislacionin primar dhe sekondar në fuqi** për Prokurim Publik, andaj AK publikon Njoftim të pabazuar në legjislacion, të pa argumentuar dhe jo përmbajtësor

Ky veprim i Autoritetit Kontraktues përbën edhe **shkelje të rënda** sipas Neni 97, pika (k) i RrPP-së nr.002/2024 citojmë:”**(k)Anulimi i aktiviteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik.**”

Poashtu, tendenca për anulimin/ndërprerjen e këtij Aktiviteti të Prokurimit në këtë mënyrë **përbën shkelje procedurale** dhe është në kundërshtim me Nenin 43, par 43.8 të Rrpp-së,

Nuk mundet AK - SPITALI FERIZAJ, në mënyrë kaq banale të vendos për anulimin e aktivitetit të prokurimit duke u munduar që përmes një ‘arsyetimi’ qeasharak të mbulojë të vertetën dhe të shkelë çdo dispozitë ligjore në mënyrë kaq flagrante. Sepse për këtë ekziston legjislacioni në fuqi primar dhe sekondar (rregullorja dhe udhezuesi).

Pra, AK- SPITALIT FERIZAJ – Në këtë fazë lehësisht mund të bëjë ndonjë përmirësim nëse vërtet dëshiron të korrigjojë/përmirësojë dhe këtë mund t bëjë me formularin **B54 – Formulari për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuar**ajgjim përmes formularit B54, sepse siq edhe elaboruam deri tani ky ‘arsyetimi’ i famshëm i Autoritetit Kontraktues se kinse duhet anuluar aktiviteti i prokurimit përmes një arsyetimi i cili gjithçka mund të jetë por vetëm **LIGJOR nuk mund të jetë.**

Prandaj, me te drejtë e kundërshtojmë Vendimin për Anulimin të datës: 25.06.2026 sepse, është nxjerrë ne shkelje të dispozitave të lartë cekura dhe në shkelje të dispozitave të nen par (d), (k) dhe (o), të par 97.1 të nenit 97 të rregullores RRPP 02/2024, për shkak të mos respektimit dhe shkeljeve të parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP dhe ne trajtim jo të barabartë të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, si dhe për shkak të sjelljeve jo profesionale dhe të gabuara të zyrtarit të prokurimit.


Dhe, rrjedhimisht, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material ne kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-se, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit , që Ankesën tonë të trajton në përputhje të plotë me dispozitat e LPP-se dhe rregulloreve në fuqi dhe argumenteve të prezantuara **dhe ta korrigjojë gabimin trashanik, tendencioz dhe të njëanshëm** duke nxjerrë vendim:

VENDIM

- ✓ Të nxjerrë vendim meritor me të cilin të aprovoj Ankesën tonë të bazuar të paraqitur nga **“LEOMED SH.P.K.”**, Prishtinë
- ✓ Te anuloj Vendimin për Anulimin të AK – **SPITALI FERIZAJ**, të datës 25.06.2026 sepse është veprim jashtë çdo etike profesionale dhe në kundërshtim të plotë me LPP-në.
- ✓ **Të Detyrojë** Autoritetin Kontraktues të **korrigjojë vendimin e marr dhe të vazhdojë Aktiviteti i Prokurimit** tashmë i publikuar.

Mbetemi me shpresë Ankesa se do të shqyrtohet pozitivisht.

Me respekt,
Xhemë Asllani



Dëmet materiale

LEOMED
MEDICAL EQUIPMENT
Nr. fiskal 601675955

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Me këto veprime AK – Spitali Ferizaj po na privon drejtpërdrejt nga e drejta ligjore për pjesëmarrje në këtë aktivitet prokurimi, duke na shkaktuar dëm të madh financiar dhe profesional. Ky bllokim artificial jo vetëm që na eliminon nga mundësia për të fituar një kontratë legjitime që do të gjeneronte të hyra dhe do të garantonte zhvillimin e biznesit tonë, por njëkohësisht na shndërron të gjitha shpenzimet e përgatitjes operative në kosto të pastra operative të humbura. Për më tepër, ky privim na dëmton në afatgjatë duke na pamundësuar krijimin e referencave të reja të punës, të cilat janë jetike për të garuar në tregun publik në të ardhmen.

1. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet